



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1118 Prot.

Tiranë, më 16. 07. 2019

### V E N D I M

**Nr. 94, Datë 16. 07. 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 11, datë 06.02.2019, e shtetas M. Sh., kundër Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjeve politike*<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesja shpjegon se më datë 02.06.2014, është emëruar me detyrë Inxhinieri Ndërtimi në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a. Me shkresën Nr. 688 prot., datë 11.12.2014, ankuesja ka kaluar nga pozicioni i Inxhinieres së Ndërtimit në atë të Inxhinieres Teknologe, pranë Degës Teknike të shoqërisë. Sipas ankueses, me emërimin në detyrë të Drejtores së Përgjithshme Zh. D., në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., filluan largimet nga puna të punonjësve të cilët ishin anëtarë të subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Me shkresën Nr. 539 prot., datë 16.05.2018, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., ka njoftuar ankuesen se, në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës Nr. 76, datë 27.04.2018, do

---

<sup>1</sup> Mbështetur në Kartën e Anëtarësisë Nr. 28834, datë 16.04.2013, ankuesja është anëtare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Gjithashtu mbështetur në vërtetimin e lëshuar nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, me Nr. 161 prot., datë 07.12.2018, M. Sh. është anëtare e Komitetit Drejtues të Lëvizjes Socialiste për Integrim për Bashkinë e Tiranës.

të zhvillohet takimi ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të suprimimit të pozicionit që ajo mban. Në vijim të procedurave të ndjekura nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., më datë 21.05.2018, është realizuar takimi ndërmjet ankueses dhe punëdhënësit, gjatë të cilit M. Sh. është vënë në dijeni të arsyes së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Në takimin e mbajtur (referuar edhe procesverbalit Nr. 539/1 prot., datë 21.05.2018), ankuesja ka shprehur pakënaqësitë e saj lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe ka kërkuar nga punëdhënësi që të emërohet në një pozicion tjetër pune për shkak të problemeve familjare (pasi ka bashkëshortin të sëmurë). Pavarësisht kontestimeve të ankueses, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., me Vendim Nr. 539/2, datë 25.05.2018, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me M. Sh..

Përsa më lart, ankuesja pretendon se largimi i saj nga puna është bërë për shkak të bindjeve politike dhe jo për shkak të ristrukturimit të shoqërisë. Sipas saj, në raport me punonjës të tjerë, ankueses nuk i është ofruar asnjë pozicion tjetër pune, por është marrë masa e largimit nga puna. Gjithashtu përpara largimit të saj apo edhe pas largimit nga detyra, në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., janë emëruar punonjës të rinj të cilët nuk plotësojnë kriteret, si dhe janë anëtarë të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, M. Sh. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Përsa më lart, me anë të shkresës Nr. 192/1 prot., datë 14.02.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjektit Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., ku i ka kërkuar informacion dhe parashtrime rreth ankesës së paraqitur nga ana e M. Sh.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën<sup>3</sup> Nr. 82/1 prot., datë 21.02.2019, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., ndër të tjera sqaroi se: *“...në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë nga elementët dhe nuk jemi përpara faktit të diskriminimit për shkak të bindjeve politike, por në rastin konkret kemi të bëjmë me suprimim të vendit të punës në zbatim të Vendimit nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës, protokolluar me tonën me nr. 286/1 prot., datë 27.04.2018...Në lidhje me pretendimin se me emërimin e Zh. D. si titullare e Shoqëria Trajtimi i Studentëve Nr. 2 sh.a., filluan largimet nga puna të punonjësve të cilët ishin anëtarë të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, ky pretendim është i pabazuar në prova dhe në fakte, pasi largimet që janë bërë pas emërimit të Zh. D., kanë qënë dorëheqje të punonjësve, zgjidhje kontratës nga ana e punëmarrësve “braktisje të vendit të punës” dhe largime për shkak të suprimimeve të vendit të punës të cilat erdhën si rezultat i miratimit të Strukturës së re të Shoqërisë me vendim nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës. Implementimi i strukturës është bërë duke rikonfirmuar gjithë pozicionet ekzistuese me strukturën e re dhe pas përfundimit të implementimit, filluan procedurat ligjore të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për ato pozicione që u suprimuan. Një nga këto pozicione ishte dhe pozicioni i Inxhinierit Teknolog, i cili siç është arsyetuar në Propozim mbi miratimin e Strukturës së Shoqërisë për vitin 2018. Po të shohim që në fillim të marrëdhënieve të punës së M. Sh. me Shoqërinë, vëmë re se ajo ka filluar punë si Inxhinier Ndërtimi në datë 02.06.2014 duke mos pasur diplomë të shkollës së lartë, pasi është diplomuar më datë 25.07.2014 dhe për më shumë nuk ka pasur arsimin e duhur për këtë post pune pasi ajo ka përfunduar studimet e larta bachelor në degën Inxhinieri Përpunim Druri. Edhe më pas, masteri profesional i kryer nga M. Sh., ka profilin Menaxhim Mjedisi duke mos u përshtatur me pozicionin e Inxhinierit Teknolog që ajo ka pasur deri në momentin e suprimimit të pozicionit të punës. Përsa më sipër pretendimi i saj se është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike dhe jo për shkak të ristrukturimit është i pabazuar në prova, pasi faktet provojnë vërtetësisht se M. Sh. i është suprimuar vendi i punës dhe se në strukturën e re nuk ka*

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 192/2 prot., datë 21.02.2019

*pasur asnjë pozicion pune që mund ti përshtatet përgatitjes profesionale të saj. Në lidhje me pretendimin se persona të tjerë janë emëruar si punonjës të rinj të cilët nuk plotësojnë kriteret, ky pretendim nuk është i bazuar në prova, pasi bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni dosjet e personave të cilët janë emëruar Inxhinier dhe kanë arsimin përkatës që i përshtatet pozicionit të punës, por edhe kualifikimet e duhura ndoshta dhe më të kualifikuar...”*

Në mbështetje të pretendimeve të tyre Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, vunë në dispozicion të Komisionerit:

- Kopje të kontratës së punës dhe të dosjes personale të M. Sh.
  - Kopje e vlerësimit të punës të subjektit ankues.
  - Informacion lidhur me performancën e saj në punë.
  - Informacion lidhur me punonjës të tjerë të shoqërisë të cilëve u është suprimuar pozicioni i punës dhe janë emëruar në një pozicion tjetër pune.
  - Kriteret që kërkohen për pozicionin e punës Inxhinier.
  - Kopje të dosjeve të punonjësve të cilët janë emëruar me detyrë Inxhinier në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”.
  - Kriteret që kërkohen për pozicionin e punës, si Specialist Planifikimi në Degën Teknike, Sektori Mjekësi apo Inxhinieri.
  - Kopje të relacionit (shkresës) me të cilën është vendosur, arsyetuar ndryshimi i pozicionit të punës së M. Sh.
  - Informacion mbi kundërshtimin gjyqësisht të ndryshimit të pozicionit të punës dhe të aktit përkatës.
- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 11, datë 06.02.2019, Komisioneri me shkresën nr. 192/3 prot., datë 15.04.2019, pasi mori miratimin e palëve në proces, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 26.04.2019.

Në seancë ishte e pranishme Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, e cila u përfaqësua nga E. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe pala ankuese M. Sh.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës, pala ankuese ritheksoi faktin se Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” kishte mundësinë për ta emëruar në një pozicion tjetër, mbështetur në arsimin e saj, por synimi përfundimtar ishte largimi nga puna për shkak të bindjeve politike.

Nga ana e përfaqësueses së Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, u theksua fakti se referuar Raportit<sup>4</sup> përfundimtar të KLSH-së lidhur me kriteret që duhet të plotësonin punonjësit, në përshtatje me pozicionin e punës, çdo pozicion pune duhet të kishte dhe arsimin përkatës në funksion të këtij pozicioni. Të gjitha këto rekomandime janë pasqyruar në ndryshimet strukturore të shoqërisë. (Vendimi nr.76, datë 27.04.2018 i Këshillit Mbikqyrës). U pa e arsyeshme që në strukturën e re, pozicionet e punës të ishin në përputhje me kriteret e reja: kështu nëse në strukturën e vjetër (Vendimi nr. 63, datë 17.11.2017 të Këshillit Mbikqyrës) kriteri arsimor për pozicionet drejtuese ishte thjesht arsim i lartë, në strukturën e re ky kriter u ndryshua në “i lartë” duke specifikuar (bachelor dhe master). Pikërisht duke bërë përshtatjen e pozicioneve të punës me arsimin përkatës dhe shkurtimi i disa pozicioneve të punës bëri që një pjesë e punonjësve të shoqërisë të largoheshin apo emëroheshin në një pozicion tjetër, përshtatur me arsimin. Referuar strukturës së vjetër (Vendimi nr. 63, datë 17.11.2017 të Këshillit Mbikqyrës), shoqëria shkuroi rreth 12 pozicione pune, duke bërë që, nga 198 punonjës sipas strukturës së vjetër, numri të shkonte në 186 punonjës me strukturën e re. Gjithashtu, me miratimin e strukturës së re u bënë edhe përshkrimet e pozicioneve të punës, pasi në strukturën e vjetër nuk ishte hartuar asnjë përshkrim pune për detyrat specifike që duhet të ushtronin punonjësit. Me implementimin e strukturës së re, u njoftuan punonjësit të cilëve u shkurohej pozicioni i punës, si p.sh.: 7 sportelist, 1 kryeinspektore etj. Në përfundim, nga ana e përfaqësueses së Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, u theksua edhe një herë se duke qënë se pozicioni i punës u shkurtua dhe arsimiti i M. Sh. nuk përshtatej me asnjë nga pozicionet e strukturës së re, atëherë u bë zgjidhja e kontratës së punës me të. Në këtë kuptim, sipas saj largimi nga puna nuk lidhet me bindjet politike të ankueses, por vetëm me shkurtimin e pozicionit të punës dhe mos përshtatjen e arsimit të saj me pozicionet e tjera në strukturë.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, me shkresën<sup>5</sup> Nr. 158/3 prot., datë 08.05.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja.

Në referim të shkresës së sipërcituar Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, sqaroi ndër të tjera se: *“... numri i punonjësve të rinj të marrë gjatë kësaj kohe që nga momenti kur i ka filluar procedura e suprimimit deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është 3, të cilët janë emëruar pranë Drejtorisë Teknike, të cilët janë: Zh. P., emëruar në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit Inxhinieri në Drejtorinë Teknike; E. Z. emëruar në pozicionin arkitekto në Drejtorinë Teknike dhe E. H. emëruar në pozicionin inxhinier Hidroteknik dhe Rrjet në Drejtorinë Teknike. Sa i përket informacionit lidhur me punonjësit e larguar që nga emërimi i Administratorit të ri janë: 6 (gjashtë) punonjës të cilët kanë braktisur pozicionin e punës; 4 (katër) punonjës të cilëve u është zgjidhur kontrata e punës me procedurë; 1 (një) punonjës të cilit i ka përfunduar*

<sup>4</sup> “Raporti Përfundimtar i KLSH”, me nr. 770/10 prot, datë 22.11.2017.

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 192/5 prot., datë 08.05.2019.

*kontrata dhe nuk i është rinovuar; 21 (njëzet e një) punonjës janë larguar me dëshirën e tyre; 11 (njëmbëdhjetë) punonjës të cilët kanë dalë në pension dhe 14 (katërmëdhjetë) punonjësve u është suprimuar vendi i punës me miratimin e Strukturës Nr. 76, datë 27.04.2018. Me miratimin e strukturës Nr. 76, datë 27.04.2019, ku u suprimuan shumë vende pune, por edhe u shtuan pozicione të reja në funksion të rikonstruksionit të godinave, për mirë menaxhimin e tyre pasi janë me standarte teknike bashkëkohore numri i punonjësve të emëruar që nga data 02.05.2018 dhe deri në këtë moment është 30 punonjës. Sot disa nga këta punonjës janë larguar me dëshirën e tyre. Sa i përket punësimit të M. Sh. në këto momente, nuk ekziston mundësia, kjo për arsyen se nuk ka asnjë pozicion që përshtatet me arsimin profesional të ankueses.”*

- Gjatë procedurës hetimore, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, me shkresën<sup>6</sup> Nr. 82/2 prot., datë 08.05.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja.

Në referim të shkresës së sipërcituar Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, sqaroi ndër të tjera se: “...Me shkresën nr. 192/1 prot., datë 14.02.2019, na është njoftuar dhe kërkuar informacion në lidhje me ankesën e M. Sh., e cila pretendon diskriminim për shkak të bindjes politike. Me shkresën nr. 82/1 prto., datë 20.02.2019 kemi dhënë shpjegimet tona se gjithë procesi i largimit nga puna i M. Sh. nuk ka të bëjë me asnjë element të karakterit diskriminues, apo në veçanti për diskriminim ‘për shkak të bindjes politike’, por është thjeshtë dhe vetëm një zgjidhje e kontratës së punës për shkak të suprimimit të pozicionit të punës në zbatim të Vendimit nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës. Për ta përforcuar arsyetimin tonë, bashkëngjitur kësaj shkrese po ju paraqesim faktin se pranë Shoqërisë, vazhdojnë të punojnë punonjës të cilët janë të anëtarësuar në forcën politike LSI, si: I. F., me detyrë Përgjegjës Sektori Mjekësi, Drejtoria Teknike; D. M., me detyrë Zv/Përgjegjëse Godina Nr. 2, Drejtoria e Mirëadministrimit; Y. Z., me detyrë Përgjegjës Emergjence, Sektori Inxhinieri, Drejtoria Teknike; Q. B. Me detyrë marangoz, Drejtoria Teknike; N. M., me detyrë Hidraulik, Drejtoria Teknike; G. T., me detyrë Punonjës Gjelbërimi, Drejtoria Tenike; Xh. B., me detyrë Sanitare, Drejtoria e Hotelërisë dhe B. D., me detyrë Receptionist Administrate, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore.”. Bashkëngjitur kësaj shkrese, Shoqëria Trajtimi i Studentëve Nr. 2, Tiranë, vuri në dispozicion të KMD-së, kartat e anëtarësisë në subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, të punonjësve të cituar në shkresën e mësipërme.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

---

<sup>6</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 818 prot., datë 29.05.2019.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Nga kqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, M. Sh. ka filluar punë pranë Shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2, Tiranë me datë 02.06.2014<sup>7</sup> në pozicionin “Inxhinieri Ndërtimi”. Më pas me Urdhërin Nr. 688 prot., datë 11.12.2014, ankuesja ka kaluar nga pozicioni i Inxhinieri Ndërtimi në pozicionin Inxhinieri Teknologe, në Drejtorinë Teknike të shoqërisë. Kjo marrëdhënie pune ka zgjatur deri në datën 25.05.2018, datë kur Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë ka përfunduar marrëdhënien e punës me të, për shkak të suprimimit të pozicionit të punës. Në dosjen e ankueses është depozituar dokumentacioni provues lidhur me kualifikimin e saj: - Diplomë Bachelor nr. 55, e Fakultetit të Shkencave Pyjore të Universitetit të Tiranës, në Inxhinieri Përpunim Druri; Diplomë të Ciklit të Dytë-Master Profesional Nr. 280, datë 06.12.2016, në Shkencat e Mjedisit, Profili Menaxhim Mjedisit.

Bazuar në aktet e administruara nga Komisioneri rezulton se, me Vendimin nr. 63, datë 17.11.2017 të Këshillit Mbikqyrës është miratuar struktura e Shoqërisë për vitin 2018, e cila në total parshikonte 192 punonjës. Nga këta 11 punonjës ishin parashikuar për Degën Teknike. Theksojmë se, referuar parashikimit të kriterit arsimor të kësaj strukture, për pozicionin e Inxhinier Teknolog ishte parashikuar që kriteri i kërkuar të ishte “Arsimi i lartë”.

Ndërkaq, nëpërmjet shkresës me nr. 770/10 prot., datë 22.11.2017 të KLSH-së<sup>8</sup> “Raport Përfundimtar dhe Rekomandime për Auditimin e Shoqërisë”, Drejtorisë së Shoqërisë dhe Këshillit Mbikqyrës iu rekomandua të marrin masa për rishikimin e strukturës organizative, për përshtatjen e vendit të punës sipas profesioneve, duke shmangur dublimet në detyrat e punonjësve dhe punësimet e panevojshme.

Në zbatim të rekomandimeve sipërcituar, të lëna nga KLSH-ja, me Vendim nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës u miratua struktura e Shoqërisë për vitin 2018, me gjithsej 186 punonjës. Dega Teknike u emërtua Drejtoria Teknike dhe gjithsej ishte parashikuar të kishte 52 punonjës. Referuar kësaj strukture, pozicioni “Inxhinier Teknolog” dhe “Kryeinspektor” janë pozicione që nuk ekzistojnë në strukturën e re të miratuar. Gjithashtu në referim të strukturës së re të miratuar me Vendim nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës, nuk ka asnjë pozicion pune në të cilin kriter arsimor të kërkohej Inxhinieri Përpunim Druri apo i Menaxhimit të Mjedisit.

Në analizë të pretendimeve dhe provave të administruara, Komisioneri administroi dokumentacionin përkatës lidhur me emërimet e reja të punonjësve të Drejtorisë Teknike apo Shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2 Tiranë, si p.sh.:

<sup>7</sup> Referuar shkresës Nr. 464 prot., datë 02.06.2014 “Emërim në detyrë”, të Shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2 Tiranë

<sup>8</sup> Shkurtesë për Kontrollin e lartë të Shtetit.

- E. H., i cili ka përfunduar arsimin Bachelor dhe Master Profesional si Inxhinier Hidroteknik, emëruar në pozicionin Inxhinier Hidroteknik dhe Rrjeti, Drejtoria Tenike, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Bachelor dhe Master në Inxhinieri Hidroteknike.
- E. Z., e cila ka përfunduar arsimin Bachelor dhe Master Profesional në Arkitekturë dhe Dizajn Urban, emëruar në pozicionin Arkitekt/Inxhinier Ndërtimi, Drejtoria Tenike, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Master në Arkitekturë/Inxhinieri Ndërtimi.
- A. M., e cila ka përfunduar arsimin e lartë në degën Administrim Publik, ku i është dhënë titulli Ekonomist për Administrimin Publik, emëruar në pozicionin Specialiste Planifikimi, Drejtoria Hoteleri, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Bachelor/Master në Shkenca Juridike, Ekonomike, Inxhinieri Ndërtimi.
- I. F., i cili ka përfunduar arsimin e lartë në fakultetin Ekonomik, Dega Financë, emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit Mjekësi, Drejtoria Teknike që më datë 20.06.2016 dhe vijon të ushtrojë këtë detyrë, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Master Shkenca Inxhinierike, Ekonomike.
- Zh. P., e cila ka përfunduar arsimin e lartë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Arkitekturë, emëruar në pozicionin Përgjegjës Sektori Inxhinieri, Drejtoria Teknike, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Master Shkenca Inxhinierike, Ekonomike.

Në analizë të emërimeve të sipërcituara dhe strukturës së shoqërisë, evidentohet se pozicionet e specialistëve kërkojnë kryesisht arsimin e lartë në Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë, Inxhinieri Hidroteknike, Juridik apo Ekonomik. Ndërsa, përsa i përket pozicioneve të punës Përgjegjës Sektori Inxhinieri apo Mjekësi, në Drejtorinë Teknike, arsimi i kërkuar është Master në Shkenca Inxhinierike apo Ekonomike. Në këtë kuptim, konstatohet se për asnjë nga pozicionet e Drejtorisë Teknike, M. Sh. nuk plotëson kriterin arsimor për tu emëruar në këto detyra duke qënë se arsimi i saj Bachelor në Inxhinieri Përpunim Druri në Master Profesional në Shkencat e Mjedisit, Profili Menaxhim Mjedisit, nuk përputhet për asnjë nga pozicionet e sipërcituara.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe*



*mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases M. Sh. nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, për shkak të “bindjes politike”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

(Shkaku: Bindja politike)

(Fusha: Punësim)